

## Raste të veçanta

### Patentë shoferi në provë

Personat të cilët kanë kaluar provimin për patentë shoferi, pas 1 dhjetorit 2005 i nënshtrohen periudhës provuese 3 – vjeçare dhe duhet të bëjnë një kurs plotësues të obligueshëm. Gjatë kësaj periudhe, në rast se iu merret patenta, sanksioni i parë aplikohet sipas përcaktimit të përshkruar në këtë dokument, dhe e zgjatë afatin kohor provues për një vit. Në rast të përsëritjes së gabimit i cili implikon një tjetër tërheqje, patenta anulohet definitivisht. Rifillimi i një kursi të ri nuk mund të paramendohet para një viti pritjeje dhe dhënjes së mendimit pozitiv nga psikologu i trafikut rrugor.

### Tërheqje e lejes pas një kundërvajtje të kryer jashtë vendit

Nëse është caktuar një ndalim vozitjeje në një vend të huaj e që vepra e kryer është vlerësuar si mesatarisht e rëndë ose e rëndë sipas Ligjit për Trafik, edhe në Zvicër do të merret vendim për tërheqjen e lejes. Kohëzgjatja do të miratohet sipas asaj se edhe në vendin ku është kryer vepra është caktuar ndalimi i vozitjes.

### Tërheqje e lejes për shkak paaftësisë për vozitje

I merret leja e vozitjes personit, aftësitë fizike dhe psikike të të cilit nuk lejojnë më që ai të vozisë sigurtë një automjet. E njëjta vlenë edhe për personat që vuajnë nga ndonjë varësi ose personat, sjelljet e mëhershme të të cilëve tregojnë se ata nuk ofrojnë garancitë e nevojshme gjatë vozitjes së një automjeti. Për shembull, në rast se drejtuesit të automjetit i gjindet përqindja prej 0,80 mg/l e alkoholit në ajrin e nxjerrur me frymëmarrje (1,60 ‰ e alkoholit në gjak), atij duhet t'i bëhet një ekspertizë mjeksore lidhur me aftësinë e tij për të drejtuar. Leja e vozitjes i merret përfundimisht vozitësit të pakorrigjueshëm.

## Njoftim në lidhje me sistemin e tërheqjes së patentë shoferit

**Nëse kam bërë shkelje ligjore të trafikut rrugor për të cilën jam denoncuar, do të hapen disa procedura (penale, administrative dhe civile). Këtu do të trajtojmë vetëm procedurën administrative, që do të thotë atë në lidhje me të drejtën e vozitjes.**

### Etapat e ndryshme

Nëse raporti i policisë i është dërguar autoritetit kompetent (Komisioni për masat administrative në lidhje me qarkullimin rrugor – CMA – në kantonin e Friburgut) i cili autoritet vepron me disa etapa. Ai duhet:

- Të përcaktoj peshën e gabimit të bërë. Ai mund të jetë **i lehtë, mesatarisht i rëndë** ose **i rëndë** (rastet e lehta të cilat sanksionohen me dënime të rendit nuk janë objekt i një procedure administrative).
- Të konsultoj regjistrin federal të masave administrative, për të verifikuar nëse vozitësi në të kaluarën ka bërë shkelje në trafik rrugor.
- Të vendos për masë të përshtatshme në funksion të minimumit të caktuar me ligj dhe faktorëve rëndues të mundshëm. Kur kjo të jetë e mundur dhe të justifikohet, do të merret parasysh nevoja profesionale për vozitje.
- Të përkujdeset në ekzekutimin, përnjëherë dhe në parim në afat prej 6 muajsh, e masës së vënë konform ligjit.

### Vlerësimi

Vlerësimi i shkeljes së ligjit varet nga gabimi i bërë e poashtu nga rreziku e cili mund të shkaktohet nga ai gabim.

### Bazat legale kryesore

Ligji federal mbi rregullimin e trafikut rrugor i 19 dhjetorit 1958 (LCR – RS 741.01)

Urdhëresa që rregullon pranimin e personave dhe të automjeteve në trafikun rrugor i 27 tetorit 1976 (OAC – RS 741.51).

### Vërejtje

Merren si të sakta vetëm versionet e këtij dokumenti në gjuhën frënge dhe gjermane, dhe, në planin juridik, tekstet legale zyrtare.

Rte de Tavel 10  
Case postale 192  
1707 Fribourg  
Tél. 026 484 55 26  
Fax 026 484 55 27  
prevention@ocn.ch

Orari  
Lundi au vendredi :  
7h30 – 16h30

## Pasojaat e shkeljes së ligjit

### E drejta për të vozitur



## Shkelje e lehtë

### Shembuj



- **Vozitja në gjendje të dehur**  
përqindja e alkoholit e matur në gjak ndërmjet 0,50 dhe 0,79 ‰ ose ndërmjet 0,25 dhe 0,39 mg/l matur në nxjerrjen e ajrit gjatë frymëmarrjes
- **Mosrespektimi i ndalesës së vozitjes nën ndikimin e alkoolit** për disa shoferë, siç janë shoferët e kamionëve ose autobusëve, shoferët nxënës dhe shoqëruesit e tyre si dhe për poseduesit e lejeve në provë 3 vjeçare
- **Tejkalimi neto i shpejtësisë prej**  
16 deri 20 km/h vend të banuar  
21 deri 25 km/h jashtë vendit të banuar  
26 deri 30 km/h në autostradë

### Masat

#### Paralajmërim

Nëse nuk figuron shkelje në regjistrin e masave administrative gjatë dy viteve të mëparshme.

#### Tërheqje për së paku 1 muaj

Nëse vozitësi ka pasur paralajmërim ose tërheqje të patentë shoferit gjatë dy viteve të mëparshme.

## Shkelje mesatarisht e rëndë

### Shembuj



- **Vozitja në gjendje të dehur**  
përqindja 0,50 dhe 0,79 ‰ e matur në gjak ose ndërmjet 0,25 dhe 0,39 mg/l matur në nxjerrjen e ajrit gjatë frymëmarrjes së bashku me një gabim tjetër të lehtë
- **Mosrespektimi i ndalësës së vozitjes nën ndikimin e alkoolit** për disa shoferë siç i përmendëm te «shkelje e lehtë» por bashkangjitur me ndonjë gabim tjetër në vozitje
- **Vozitje e automjetit pa patentë shoferi adekuat**
- **Tejkalimi neto i shpejtësisë prej**  
21 deri 24 km/h në vend të banuar  
26 deri 29 km/h jashtë vendit të banuar  
31 deri 34 km/h në autostradë

### Masat

#### Tërheqje për së paku 1 muaj

Nëse vozitësi nuk ka bërë shkelje gjatë dy viteve të mëparshme.

#### Tërheqje për së paku 4 muaj

Nëse vozitësit i është marrë një herë patenta për shkelje të rëndë ose mesatarisht të rëndë gjatë dy viteve të mëparshme.

#### Tërheqje për së paku 9 muaj

Nëse vozitësit i është marrë dy herë patenta për shkelje mesatarisht të rëndë ose një herë për arsye të rëndë dhe një herë për arsye mesatarisht të rëndë gjatë dy viteve të mëparshme.

#### Tërheqje për së paku 15 muaj

Nëse vozitësit i është marrë patenta dy herë për shkelje të rënda gjatë dy viteve të mëparshme.

#### Tërheqje me afat të pacaktuar për së paku 2 vite

Nëse vozitësit i është marrë patenta tri herë për shkelje të vlerësuara së paku mesatarisht të rënda brenda 10 viteve. Nëse nga tërheqja e fundit ka më shumë se pesë vite, masa sillet në 1 muaj.

## Shkelja e rëndë

### Shembuj



- **Vozitja në gjendje të dehur**  
prej 0,80 ‰ alkoholi matur në gjak ose prej 0,40 mg/l matur në nxjerrjen e ajrit gjatë frymëmarrjes
- **Kundërshtimi i alkotestit ose analizave të tjera**
- **Ndikimi i drogës apo medikamenteve (barnave)**
- **Vozitja gjatë kohës sa është bërë tërheqja (marrja e patentës nga autoritetet)**
- **Tejkalimi neto i shpejtësisë prej**  
Prej 25 km/h në vend të banuar  
Prej 30 km/h jashtë vendit të banuar  
Prej 35 km/h në autostradë.

### Masat

#### Tërheqje për së paku 3 muaj

Nëse vozitësi nuk ka bërë shkelje gjatë pesë viteve të mëparshme.

#### Tërheqje për së paku 6 muaj

Nëse vozitësit i është marrë një herë patenta për shkelje mesatarisht të rëndë brenda pesë viteve.

#### Tërheqje për së paku 12 muaj

Nëse vozitësit i është marrë patenta një herë për shkelje të rëndë ose dy herë për shkelje mesatarisht të rënda në pesë vitet e mëparshme.

#### Tërheqje me afat të pacaktuar për së paku 2 vite

Nëse vozitësit i është marrë dy herë patenta për arsye të rënda ose tre tjera për arsye mesatarisht të rënda brenda dhjetë viteve. Nëse ka më shumë se pesë vite nga tërheqja e fundit, masa reduktohet në 3 muaj.

#### Tërheqje përfundimtare

Patenta i merret definitivisht vozitësit i cili bënë shkelje të rëndë apo mesatarisht të rëndë, në pesë vitet që pasojnë nga pushimi i një tërheqje legale me afat të pakufizuar.

## Kundërvajtje e shoferit të pakujdesshëm

### Shembuj



Konsiderohet shofer i pakujdesshëm secili që tejkalon shpejtësinë maksimale të lejuar:

- **të paktën 40 km/h, aty ku është kufizuar shpejtësia maksimale 30 km/h**
- **të paktën 50 km/h, aty ku është kufizuar shpejtësia maksimale 50 km/h**
- **të paktën 60 km/h, aty ku është kufizuar shpejtësia maksimale 80 km/h**
- **të paktën 80 km/h, aty ku është kufizuar shpejtësia maksimale mbi 80 km/h**

### Masat

#### Tërheqje e lejes më së paku 24 muaj

Për kundërvajtjen e parë të shoferit të pakujdesshëm.

#### Tërheqje përfundimtare ose të paktën për 10 vitetë lejes

Në rast të përsëritjes së kundërvajtjes nga shoferi i pakujdesshëm.

#### Me rëndësi

Njihet gjithashtu si shofer i pakujdesshëm ai i cili shkel qëllimisht rregullat themelore të trafikut, që rrezikon me aksident, pasojat e të cilit do të shkaktonin lëndime të rënda ose vdekje, veçanërisht gjatë kryerjes së parakalimeve të pamatura ose pjesëmarrjen në gara me shpejtësi të paligjshme.